

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh.Q., nga Peja, ... për shkak të veprës penale Mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.481/17, datë 14.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më 28.05.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit Xh.Q., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.481/2017, i datës 22.02.2018, **Vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.481/17, datë 14.02.2018, të akuzuarin Xh.Q. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilin dënim është obliguar ta paguaj në afat prej 90 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e nëse në afatin e paraparë nuk mund të paguaj dënimin, i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, duke i'u llogaritur çdo 20€ të gjobës për një ditë burgim, si dhe e ka gjykuar me dënim m burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 06.04.2017 deri më datë 03.05.2017. Gjykata konform nenit 62 par. 1 dhe par. 2 nën par. 2.7 të KPRK-së, ka konfiskuar 21 aplikacione, 1 laptop të tipi HP – me ngjyrë të zezë, të hollat në shumë prej 3180€ të sekuestruara sipas urdhërit të Gjykatës Themelore në Pejë DP.PP.nr.74/17 të datës 06.04.2017, me ç'rast të njëjtat të holla kthehen në buxhetin e Kosovës. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit taksën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari Xh.Q., dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta

anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje, apo të akuzuarit dënimin me burg t'ia shndërroj në dënim me kusht.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.348/2018, datë 16.04.2018, ka propozuar që të ankesa e të akuzuarit të hudhet si e palejuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullti njoftoj palët. Në seancë prezantuan të dëmtuarit V.Sh. dhe S.K.. Të dy të dëmtuarit deklaruan se i bashkëngjiten ndjekjes penale dhe parashtrajnë kërkesë pasurore juridike, më tepër nuk shtuan. Prokurori i Apelit, i akuzuari Xh.Q. dhe palët tjera të dëmtuara, edhe pse të njoftuara me kohë, nuk prezantuan në seancë

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

**Ankesa sa i përket vendimit mbi dënimin nuk është e bazuar, ndërsa sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike hudhet si e palejuar.**

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë vlerëson se një ankesë e tillë është e palejuar, ngase në ankesë nuk mund të kontestohet gjendja faktike, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, andaj ankesa e të akuzuarit lidhur me këtë bazë hudhet si e palejuar.

Në ankesë, i akuzuari e ankimon aktgjykimin lidhur me vendimin mbi dënim, ashtu që kërkon nga Gjykata e Apelit që të merr parasysh rrethanat, si sëmundjen e pashërueshme dhe ngjithëse të të akuzuarit, faktin se ka pranuar fajësinë. Në ankesë i akuzuari pretendon se me rastin e sëmundjes së tij ka shpenzime të mëdha dhe i njëjti nuk është në gjendje të mbaj dënimin me burg, sepse është barrë e madhe, andaj i propozon Gjykatës së Apelit që të njëjtin dënim me burg të i'a shndërroj në dënim me kusht.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, ka pasur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, është

penduar për veprën e kryer, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin nuk ka gjetur, përveç rrezikshmërisë shoqërore të veprës. Andaj, në prani të këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Pavarësisht rrethanave të cekura në ankesën e të akuzuarit, kjo gjykatë vlerëson se të njëjtat nuk e kanë rëndësinë e tillë që të justifikojnë një dënim me kusht, siç kërkohet në ankesën e të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh rrethanat e lartcekura, e sidomos pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, kjo gjykatë vlerëson se ka shqiptuar dënim të drejtë. Andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e meqenëse në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re lehtësuese, e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit i'a ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.339/18, datë 28.05.2018

Zyrtari ligjor  
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit  
Hashim Çollaku

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Biljana Rexhiq